



REPUBLIKA E KOSOVËS /
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

C.nr.533/10

GJYKATA KOMUNALE NË PRIZREN, gjyqtari Valon Totaj, me procesmbajtësen Drita Qerreti, në kontestin e paditësit DPT “Gj.” Prizren, me pronarë J. P. nga Prizreni, kundër të paditurit F. P. “T. A.” me pronar Z. Q. nga Prizreni, për shkak të pagesës së borgjit, vlera e kontestit 88 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me datën 24.05.2011, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET kërkespadia e paditësit DPT “Gj.” Prizren, me pronarë J. P. nga Prizreni, përmes të cilës ka kërkuar që të obligohet i padituri F. P. “T. A.” me pronar Z. Q. nga Prizreni, që paditësit t’ia kthej borgjin e drunjëve në shumë prej 88 euro, si dhe shpenzimet procedurale në lartësi prej 165 euro, **si tërësisht e PABAZUAR.**

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi DPT “Gj.” Prizren me pronarë J. P. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate ka parashtruar propozim për ekzekutim në bazë të dokumentit të vlefshëm, kundër të paditurit F. P. “T. A.” me pronar Z. Q. nga Prizreni. Me datën 06.04.2009, gjykata ka marr aktvendimin E.nr.491/09, për caktimin e përmbarimit të propozuar.

Me datën 18.11.2009, i padituri – pronari i F. “T. A.” Z. Q., është paraqitur pranë gjykatës me ç’rast ka deklaruar në procesverbal se nuk është i obliguar që t’ia paguaj këtë borxh paditësit, ngase drunjët kontestuese nuk i ka porositur ai por një ish punëtori i tij, emri të cilit nuk i është kujtuar. Ky punëtor këto dru i kishte blerë në emër të furrës “T. A.”, por sipas deklarimit të pronarit të furës Z. Q., ky i fundit këto dru as që i ka blerë e as që i ka porositur. Sipas tij, kreditori këtë borxh duhet ti’a kërkoj personit që i ka shitur këto dru, duke e kundërshtuar në tërësi borxhin e lartëcekur. Ka shtuar se për këtë fakt kreditori nuk posedon asnjë dokument në të cilën figuron nënshkrimi i tij (debitorit), në lidhje me faktin ai i ka porositur apo blerë ato dru.

Me datën 08.07.2010, kjo gjykatë në procedurë përmbarimore ka marrë konkluzion përmes të cilit është shfuqizuar aktvendimi për lejim të përmbarimit E.nr.

491/09, i datës 06.04.2009, ndërsa që propozimi për egzekutim i kreditorit, është konsideruar padi.

Seanca e shqyrtimit kryesor për këtë çështje juridiko kontestimore është mbajtur me datën 24.05.2011, në munges të të paditurit të ftuar në mënyrë të rregullt, e konform nenit 423 .4 të LPK-së.

Në këtë seancë, tani paditësi pronari i firmës DPT “Gj.” J. P., ka deklaruar se mbetet në tërsi pranë tani padisë dhe kërkesëpadisë duke i propozuar gjykatës që të njejtën ta aprovoj në tërsi si të bazuar, ashtu që ta detyroj këtu tani të paditurin që t’ia paguaj borxhin e druve në lartësi prej 88 eurove, si dhe shpenzimet procedurale të cilat edhe i ka specifikuar në këtë seancë.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të tjera, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se:

Kërkespadia e paditësit është e **pa bazuar**.

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provën: **kuponi** me nr. 0047182 i dt. 11.02.2009, si dhe ka bërë dëgjimin e **dëshmitarit H. S. N.** nga fshati S. Komuna e Suharekës.

Nga leximi i kuponit me nr. 0047182, të datës 11.02.2009, gjykata ka vërtetuar se në këtë kupon egziston përshkrimi i mallit – dru, në sasi prej 2m³ (dy metra kub), në çmim të përgjithshëm prej 88 eurove, për “Z.-f. Prizren”. Në kupon egziston vetëm nënshkrimi i pronarit të firmës DPT “Gj.”- J. P.

Gjykata ka bërë dëgjimin e dëshmitarit H. S. N., i lindur më 20.11.1970 në fshatin M. komuna e Suharekës, tani me banim në fshatin S. Komuna e Suharekës, përndryshe nuk është në gjini gjaku me palët ndërgjyqëse, e i cili para kësaj gjykate ka deklaruar: “Këtu paditësin e njoh nga se shpesh atij i kam kryer shërbimet e transportit për bartjen e drunjëve. Përndryshe nuk jam i punësuar tek paditësi. Nuk më kujtohet saktësisht se kur, por e di se ka qenë kohë e ftoftë kur këtu i padituri Z. Q. më ka telefonuar dhe ka kërkuar nga unë 2m dru, me ç’rast po atë ditë i’a kam dërguar këto dru. Me rastin e shkarkimit të druve, i padituri Z. nuk ka qenë prezent, por prezent ka qenë një punëtor i tij. Pagesa nuk është bërë, ngase i njejtë siq e ceka më lart, nuk ka qenë prezent. Pas afërsisht 2 javëve, pasi që të paditurit i’u kishin hargjuar drutë, i njejtë përsëri më ka telefonuar dhe ka kërkuar nga unë që t’ia dërgoj edhe 2m dru, duke më thënë se do t’ia paguaj edhe ato 2m të cilat i kisha dërguar më herët, e edhe këto që do t’ia dërgoja tani. Të njejtën ditë ja dërgova drutë me ç’rast të njejtat i shkarkova, por pas kësaj i padituri deklaroj se nuk kam para për të paguar me arsyetimin se e kishte një denim dhe se nuk ishte në gjendje që tani t’i paguaj drutë. Pas kësaj këto 2m dru përsëri i ngarkova në kamion dhe i dërgova në firmën e paditësit ndërsa që i padituri mbeti borxh për ato 2m dru të cilat ja kisha dërguar para dy javëve. Pas kësaj të paditurin e kam takuar një here ku edhe i’a kam kërkuar parat por i njejtë ishte larguar pa e bërë këtë pagesë. Kuponin – faturën i’a kam dorëzuar një punëtorje- shitëse e cila ishte duke punuar në këtë furrë. Për të kërkuar borxhin kemi shkuar disa here me ç’rast asnjher nuk e kemi gjetur pronarin Z. Q., por jemi takuar me disa punëtor të cilat nuk kanë qenë në gjendje të na japin kurrfarë përgjegje. Përndryshe i padituri Z., për këto 2m dru të kontestuar, ka kontaktuar dhe i ka

porositur përmes meje e jo përmes këtu paditësit, por të këto dru unë i kam marr nga këtu paditësi. Shpenzimet e dëshmisë i kërkoj dhe atë në lartësi të një meditjeje prej 25 eurove”.

Me nenin 17 Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), është e paraparë se *“pjesëmarrësit e detyrimit kanë për detyrë që ta zbatojnë detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij”*, ndërsa me nenin 262 të po këtij ligji, është paraparë se *“kreditore në raportin e obliguar është i autorizuar që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush me ndërgjegje krejtësisht sikundër është përmbajtja e tij”*.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar, nuk është provuar se këtu i padituri Z., ka detyrime-borgj, ndaj paditësit J. P. Kjo ngase me asnjë provë nuk është provuar se në mes tyre ka pasur ndonjë marrëveshje-kontratë, e cila për pasojë do të krijonte të drejta dhe detyrime reciproke në mes tyre. Gjithashtu gjykata ka konstatuar se në mes palëve nuk janë krijuar as raporte të cedimit të borgjit, respektivisht të marrjes përsipër të borgjit nga ana e këtu të paditurit, i cili fakt eventualisht do t'i jepte të drejtë paditësit që tani borgjin ta kërkoj nga i padituri. Deri tek ky konstatim gjykata ka ardhur përmes provave të lartcekura të cilat janë administruar në këtë procedurë, e sidomos përmes dëshmisë së dëshmitarit H. S. N., i propozuar nga ana e vet paditësit, i cili para kësaj gjykate ka deklaruar se këtu i padituri Z., drutë kontestuese i kishte porositur nga ai e jo nga paditësi J. P. Ky dëshmitar po ashtu ka deklaruar se nuk është në marrëdhënie pune te këtu paditësi. Duke qenë se i padituri drutë kontestuese i kishte porositur nga këtu dëshmitari H. S. N., e jo nga paditësi, ndërsa që dëshmitari H., nuk ishte, e as që është në marrëdhënie pune te këtu paditësi J. P., që nënkupton se i njëjti nuk e ka përfaqësuar atë e as që ka mundur të kontrakttoj diçka në emër të tij, gjykata ka konstatuar se në mes të këtu palëve ndërgjyqëse nuk ka pasur marrëveshje-kontratë, e cila do të prodhonte të drejta dhe detyrime reciproke në mes të tyre. Ky fakt ka qenë vendimtar për këtë çështje ngase këtu pala e paditur nuk mund të obligohet për ndonjë prestim, nga personi (në këtë rast paditësi), i cili nuk ka qenë palë kontraktuese. Në bazë të të lartcekurave, gjykata i'a fali besimin deklarimit të të paditurit të dhënë ne procesverbalin e datës 18.11.2009, si dhe dëshmisë së dëshmitarit H. S. N., ngase gjeti se të njëjtat vërtetojnë faktin se këtu i padituri nuk ka detyrime ndaj këtu paditësit.

Sa i përket deklarimeve të paditësit, të njëjtave gjykata nuk ua fali besimin ngase gjeti se ato janë në kundërshtim me provat e administruara si dhe me dëshminë e dëshmitarit të propozuar nga vetë paditësi.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e konform nenit 143 të LPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 452.4 të LPK-së.

GJYKATA KOMUNALE NË PRIZREN
C.nr.533/10, datë 24.05.2011

Procesmbajtësja,
Drita Qerreti

Gjyqtari,
Valon Totaj

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Qarkut në Prizren, nëpërmjet të kësaj gjykate. Aktgjykimi mund të goditet vetëm për shkak të shkeljes esenciale të dispozitve mbi procedurën kontestimore dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.